



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/103  
Datë: 28.10.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/103  
Datë: 28.10.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti Nëntëmujor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2022.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia dorëzojë Kuvendit të Republikës së Kosovës, konform kërkesave të nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/103  
Datë: 28.10.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 25, paragrafi 3. të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, i propozon Kuvendit të Republikës të Kosovës, zgjatjen e masave emergjente në furnizimin e energjisë, me qëllim të normalizimit të plotë të gjendjes në nivel të shtrirjes dhe kohëzgjatjes së nevojshme, edhe prej (30) ditësh.
2. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit Nr. 01/91 të datës 31 korrik 2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e emergjencës në furnizimin e energjisë, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës Nr. 08-V-384 me datë 4 gusht 2022 dhe Vendimit Nr.01/98 të datës 23 shtator 2022 për zgjatjen e masave emergjente në furnizimin me energji të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës Nr.08-V-396 me datë 3 tetor 2022.
3. Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/103  
Datë: 28.10.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimit të Qeverisë Nr.13/19 të datës 14 korrik 2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25 gusht 2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17 dhjetor 2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23 shkurt 2022 dhe Vendimin Nr. 04/90 të datës 26 korrik 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 10/102 të datës 26 tetor 2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 500,000.00 €, (pesëqind mijë euro) në zbatim të masës 4.3 - Mbështetja e Kulturës dhe Sportit.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (207) në nën-programin "Përkrahja e Kulturës" me kod 80500, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për ekzekutimin e pagesave të realizuara të aktiviteteve të edicionit të 14-të të Manifesta 14 Prishtina 2022.
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministria së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/103  
Datë: 28.10.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2022, merr këtë:


**V E N D I M**

1. Të gjithë pronarëve të mjeteve të pajisura me targa "PR", "KM", "PZ", "GL", "UR", "PE", "DA" apo "ĐA" nga 10 qershori i vitit 1999 deri më datë 21 prill 2022, u mundësohet regjistrimi i mjeteve me targa RKS.
2. Regjistrimi i mjeteve të përcaktuara si në pikën 1. të këtij Vendimi, do të zgjasë deri me datën 21 prill 2023.
3. Nga data 1 nëntor 2022 deri me datën 21 nëntor 2022, do të shqiptohet masa qortim ndaj pronarëve të automjeteve me targa "PR", "KM", "PZ", "GL", "UR", "PE", "DA" apo "ĐA", kurse për të njëjtët, nga data 21 nëntor 2022 deri me datën 21 janar 2023, do shqiptohet gjoba e paraparë sipas legjislacionit në fuqi.
4. Mjetet sipas pikës 1 të këtij Vendimi, që hyjnë në këtë fushëveprim, vetëm për periudhën 1 shtator 2022 deri më 31 mars 2023 konsiderohen mallra të nacionalizuara.

5. Pas datës 31 mars 2023 deri me datë 21 prill 2023, për mjetet sipas pikës 1 të këtij Vendimi, mundësohet regjistrimi me targa RKS pa u konsideruar mallra të nacionalizuara në kuptim të pikës 4 të këtij Vendimi.
6. Për pronarët e mjeteve të pajisura për herë të parë me targa “PR”, “KM”, “PZ”, “GL”, “UR”, “PE”, “DA” apo “ĐA” pas datës 21 prill 2022, nuk mundësohet regjistrimi me targa RKS, hyrja dhe/apo qarkullimi në territorin e Republikës së Kosovës.
7. Të gjitha mjetet me targa të regjistrimit të Serbisë, që paraqiten për kalim të kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës dhe kanë për qëllim të lëvizin në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe mjetet që tashmë janë në qarkullim në territorin e Republikës së Kosovës, duhet të kenë të vendosur ngjitësin në pjesën e simboleve dhe emërtimit shtetëror sipas pikës 3 të Vendimit të Qeverisë Nr.02/85 të datës 29.06.2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr.08/102 të datës 26.10.2022. Mekanizmi i aplikimit të letrës ngjitëse është pa paragjykim ndaj afatit maksimal të qëndrimit të automjeteve të tilla në territorin e Republikës së Kosovës sipas nenit 41 të Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete.
8. Nga data 21 janar 2023, për të qarkulluar dhe/apo hyrë në territorin e Republikës së Kosovës, obligohen të gjithë pronarët e mjeteve të pajisura me targa “PR”, “KM”, “PZ”, “GL”, “UR”, “PE”, “DA” apo “ĐA” nga 10 qershori i vitit 1999 deri më datë 21 prill 2022, të pajisen me targa provuese. Nga kjo datë, aplikimi i letrës ngjitëse vetëm për këtë kategori të mjeteve zëvendësohet me obligimin e pajisjes me targa provuese.
9. Pavarësisht pajisjes me targa provuese sipas pikës 8 të këtij Vendimi, pronarët e mjeteve të pajisura me targa “PR”, “KM”, “PZ”, “GL”, “UR”, “PE”, “DA” apo “ĐA” nga 10 qershori i vitit 1999 deri më datë 21 prill 2022, regjistrimin me targa RKS duhet ta bëjnë brenda afatit të përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi.
10. Pas datës 21 prill 2023, pronarët e mjeteve të pajisura me targa “PR”, “KM”, “PZ”, “GL”, “UR”, “PE”, “DA” apo “ĐA” nga 10 qershori i vitit 1999 deri më datë 21 prill 2022, nuk do të kenë më mundësinë që këto mjete t’i regjistrojnë me targa RKS, të hyjnë apo të qarkullojnë në dhe përmes territorit të Republikës së Kosovës.
11. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe agjencitë e saj që të ndërmarrin të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme me qëllim të realizimit të procesit sipas këtij Vendimi si dhe të bëjnë bashkërendimin e procesit të regjistrimit në koordinim me ministritë relevante.
12. Obligohen Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe të gjitha institucionet tjera relevante që pas datës 21 prill 2023, të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.

13. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi Nr. 01/85 i datës 29.06.2022 dhe Vendimi Nr.01/97 i datës 20.09.2022.

**Albin KURTI**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zevëndeskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë.